



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2316/7 Prot.

Vlorë më, 28.08. 2026

VENDIM

Nr. 53, datë 28.08.2026

PËR

**PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE TË REALIZUAR PËR STAFIN
AKADEMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Në mbështetje të nenit 49, të ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma e të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*", datë 10.09.2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*", Vendimi Nr.11, datë 30.09.2024 i Rektorit të UV "*Për ndarjen e ngarkesës mësimore vjetore të pedagogëve për cdo vit akademik*", si dhe referuar propozimit të Administratorit nr.2240 prot, datë 14.08.2026 dhe Vendimit të Senatit akademik nr. 41 prot, datë 29.07.2026, në mbledhjen e datës 28.08.2026 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e mbingarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2025-2026 deri në 200 orë në auditor.
2. Të miratojë pagesën e mbingarkesës mësimore për vitin akademik 2025-2026 nga 200-300 orë për orët suplementare në auditor, vetëm për rastet kur eksizton propozimi i njësisë bazë dhe miratimi i drejtuesit të njësisë kryesore, sipas kërkesave të Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*".
3. Orët e mbingarkesës mësimore që tejkalojnë 300 orë, nuk do të paguhen.
4. Në këtë mbingarkesë mësimore nuk përfshihen temat e diplomave në të tri ciklet e studimit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademik në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët

Alma Bakiu

Enida Pulaj

Elmira Kushta

Ledina Mançka

Orkida Hasani

KRYETAR

Saniela Xhaferi

